



Data: 08.08.2017 Ref.: 660117

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 52-të, të mbajtur më 28 Korrik 2017, mori:

#### V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa nr.553/17, datë 18.07.2017 e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë për rishqyrtim të vendimit të KSHC-së nr.538/17, datë 06.07.2017 si e pabazuar.
- II. Mbetet në fuqi vendimi i KSHC-së nr.538/17, datë 06.07.2017
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

#### Arsyetimi

Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë me 18.07.2017 ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim të vendimit të KSHC-së nr. 538/17, datë 06.07.2017, me të cilin vendim Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë nuk është akredituar programi i studimit: Shkenca e Ushqimit, MSc 120 ECTS. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, KSHC ka konstatuar që institucioni në fjalë nuk ka sjellë asnjë dëshmi mbi bazën e të cilës do të mund të merrej parasysh për të ndryshuar vendimin e KSHC-së. KSHC konsideron se gjendja faktike në kohën e vlerësimit të aplikacionit të Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë është trajtuar me saktësi maksimale nga AKA.

Vendimi i KSHC për mos riakreditim të programeve të studimit të Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, është në përputhje të plotë me nenin 22, pika 2 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (UA nr.20/2016, datë 20.09.2016) ku thuhet: “Duke u bazuar në rekomandimet nga raporti i ekspertëve, KSHC do të vendos për akreditim ose mos akreditim”.

Andaj, bazuar në dispozitat e cekura me lartë, KSHC në mbledhjen e mbajtur me 28 korrik 2017, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqes padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative. Afati për paraqitjen e padisë është 30 ditë nga momenti i pranimet të këtij vendimi përfundimtar.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.

  
Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

